



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 17

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8883 datë 18.4.2002	Për ratifikimin e “Protokollit të dytë shtesë të “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”	509
Ligj nr.8884 datë 22.4.2002	Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925, datë 19.4.1995; nr.8159, datë 7.11.1996 dhe nr.8333, datë 23.4.1998	522
Ligj nr.8885 datë 22.4.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me ligjin nr.8067, datë 15.2.1996; nr.8099, datë 28.3.1996; nr.8158, datë 7.11.1996; nr.8237, datë 1.9.1997; nr.8482, datë 10.5.1999 dhe me dekretet nr.1195, datë 14.8.1995 dhe nr.1615, datë 20.9.1996.....	523

Ligj nr.8886 datë 22.4.2002	Për një ndryshim në ligjin nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”	524
Ligj nr.8887 datë 22.4.2002	Për një ndryshim në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me ligjin nr.8459, datë 11.2.1999 dhe ligjin nr.8582, datë 23.2.2000	524
Vendim i KM nr. 149, datë 25.4.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.154, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin e veprimtarive prodhuese në industrinë joushqimore"	525
Vendim i KM nr. 151, datë 25.4.2002	Për statusin "Dëshmor i Atdheut"	525
Vendim i KM nr.152, datë 25.4.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", me ndryshimet përkatëse	527
Vendim i KM nr. 153, datë 25.4.2002	Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror.....	528
Vendim i KM nr.154, datë 25.4.2002	Për të drejtat dhe detyrat e Inspektoratit të Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve	533
Vendim i KM nr. 155, datë 25.4.2002	Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve	534
Vendim i KM nr. 156, datë 25.4.2002	Për organizimin dhe procedurat e kryerjes së certifikimit të materialit mbjellës, bimor	535
Vendim i KM nr. 157, datë 25.4.2002	Për kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialin mbjellës, bimor	536
Vendim i KM nr. 158, datë 25.4.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 404, datë 24.10.1991 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e personaliteteve të larta shtetërore”, ne ndryshimet përkatëse, si dhe për caktimin e dietës ditore të ministrave, zëvendësministrave dhe personave të tjerë, të barazuar me ta	539
Vendim i KM nr. 176, datë 3.5.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 450, datë 1.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e qytetit antik të Butrintit"	540
Vendim i KM nr. 180, datë 3.5.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 227, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dhënies në koncesion të hidrocentralit në Smokthinë"	541

Vendim i KM nr. 181, datë 3.5.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 355, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dhënies në koncesion të hidrocentraleve vendore" nr. 185, datë 3.5.2002.....	541
Vendim i KM nr. 185, datë 3.5.2002	Për disa shtesa në vendimin nr. 397, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë”	542
Vendim i KM nr. 186, datë 3.5.2002	Për një shtesë në vendimin nr. 68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit"	542
Vendim i KKRT nr.85, datë 29.3.2002	Për dhënie licence për radio vendore private “Boom Boom”	543
Vendim i KKRT nr.86, datë 29.3.2002	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “Adria 2”	543
Vendim i KKRT nr.87, datë 29.3.2002	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “News 24”	544
Vendim i KKRT nr.88, datë 29.3.2002	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV Margit”	544
Vendim i KKRT nr.89, datë 29.3.2002	Për dhënie licence për radio FM kombëtare private “Radio+2”	545

LIGJ
Nr. 8883, datë 18.4.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË DYTË SHITESË TË “KONVENTËS SË
KËSHILLIT TË EUROPËS PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN
PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i dytë shtesë i “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3314, datë 29.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

PROTOKOLLI I DYTË SHITESË
I KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË
NË FUSHËN PENALE

Strasburg 8.11.2001

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, që kanë nënshkruar këtë Protokoll:

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tyre sipas Statutit të Këshillit të Europës;

Duke dashur të kontribuojnë më tej për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe mbështetjen për një shoqëri demokratike;

Duke e konsideruar këtë të rëndësishme për forcimin e kapacitetit individual e kolektiv për t’iu përgjigjur krimit;

Vendosën të përmirësojnë dhe shtojnë aspekte të caktuara të Konventës Europiane për Ndhmë të Ndërsjellë Gjyqësore në Fushën Penale, Strasburg 20 prill 1959 (këtu referuar si Konventa), si edhe Protokollit shtesë të saj, Strasburg 17 mars 1978;

Duke pasur në konsideratë Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Romë 4 nëntor 1950, si edhe Konventën për Mbrojtjen e Personave nga Procesimi Automatik i të Dhënave Personale, Strasburg 28 janar 1981;

Ranë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1

Neni 1

Qëllimi

Neni 1 i Konventës zëvendësohet me dispozitën e mëposhtme:

1. Palët i japin njëra-tjetrës, sipas dispozitave të kësaj Konvente, ndihmë të ndërsjellë gjyqësore maksimale në mënyrë të menjëhershme në lidhje me veprat penale, dënimi i të cilave, në kohën e paraqitjes së kërkesës për ndihmë, është brenda juridiksionit të autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese.

2. Kjo Konventë nuk është e zbatueshme për arrestimet, zbatimin e vendimeve ose veprat penale sipas ligjit penal ushtarak, të cilat nuk janë vepra penale, bazuar në të drejtën penale.

3. Ndihma e ndërsjellë gjyqësore mund të jepet edhe në procedimet e nisura nga autoritetet administrative në lidhje me aktet e dënueshme si shkelje ligjore, sipas të drejtës kombëtare të Palës kërkuese ose të kërkuar, vendimi për të cilat mund të çojë në një procedim penal përpara një gjykate me juridiksion të posaçëm për çështjet penale.

4. Ndihma e ndërsjellë gjyqësore nuk refuzohet vetëm mbi bazën se ajo lidhet me vepra penale, për të cilat personi mund të konsiderohet fajtor nga Pala kërkuese.

Neni 2

Prania e përfaqësuesve të Palës kërkuese

1. Nenin 4 i Konventës shtohet me dispozitën e mëposhtme, duke e bërë nenin 4 të Konventës aktuale paragrafin 1 dhe dispozitën e mëposhtme paragrafin 2.

2. Kërkesa për praninë e përfaqësuesve të Palës kërkuese ose personave të interesuar nuk duhet të refuzohet në ato raste kur kjo prani ka të ngjarë ta bëjë zbatimin e kërkesës për ndihmë gjyqësore më të përgjegjshme ndaj nevojave të Palës kërkuese dhe si pasojë shmang nevojën për kërkesa shtesë për ndihmë gjyqësore.

Neni 3

Transferimi i përkohshëm i personave të dënuar në territorin e Palës kërkuese

Neni 11 i Konventës zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

“1. Një person i ndaluar, paraqitja personale e të cilit në gjyq bëhet për qëllime dëshmie dhe jo për t’u gjykuar, transferohet përkohësisht në territorin e Palës kërkuese, duke marrë sigurinë se ai apo ajo do të kthehet brenda kohës së përcaktuar nga Pala e kërkuar, në zbatim të dispozitave të nenit 12 të kësaj Konvente.

Transferimi mund të refuzohet kur:

a) personi i ndaluar nuk jep pëlqimin e tij;

b) paraqitja e tij apo e saj është e nevojshme për një procedim penal të hapur në territorin e Palës së kërkuar;

c) ky transferim ka të ngjarë të zgjasë periudhën e ndalimit;

d) ka arsye të forta për moskryerjen e këtij transferimi në territorin e Palës kërkuese.

2. Sipas nenit 2 të kësaj Konvente, paragrafi 1, kalimi tranzit i një personi përmes territorit të një Pale të tretë, bëhet pas paraqitjes së kërkesës, shoqëruar me dokumentet e nevojshme nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese, Ministrisë së Drejtësisë së Palës së Tretë, përmes së cilës do të bëhet tranziti. Kjo Palë mund të refuzojë të japë tranzit shtetasve të tij.

3. Personi i transferuar do të mbahet në paraburgim në territorin e Palës kërkuese dhe, kur është e mundur, në territorin e Palës përmes së cilës është kërkuar tranziti, përderisa Pala prej së cilës është kërkuar transferimi nuk aplikon për lirimin e tij ose të saj.”.

Neni 4

Rrugët e komunikimit

Neni 15 i Konventës do të zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

“1. Kërkesa për asistencë reciproke, si dhe informacioni spontan do të adresohet me shkrim nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e Palës së kërkuar dhe do të kthehet nëpërmjet të njëjtës rrugë.

Megjithatë, ato mund të nisen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore të Palës kërkuese tek autoritetet e Palës së kërkuar dhe të kthehen përmes së njëjtës rrugë.

2. Aplikimet, siç parashikohen në nenin 11 të kësaj Konvente dhe nenin 13 të Protokollit të Dytë shtesë të kësaj Konvente, në të gjitha rastet do t'i adresohen nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë së Palës së kërkuar dhe të kthehet nëpërmjet rrugëve të njëjta.

3. Kërkesa për asistencë reciproke lidhur me procedurat, siç parashikohen në paragrafin 3 neni 1 të kësaj Konvente, mund të kalohet direkt nga autoritetet administrative dhe gjyqësore të Palës kërkuese tek autoritetet administrative dhe gjyqësore të Palës së kërkuar, sipas rastit, dhe të kthehen përmes së njëjtës rrugë.

4. Kërkesat për asistencë reciproke, të bazuara në nenet 18, 19 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Konvente, mund të nisen direkt nga autoritetet kompetente të Palës kërkuese tek autoritetet kompetente të Palës së kërkuar.

5. Kërkesat e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 13 të kësaj Konvente mund të nisen direkt nga autoritetet gjyqësore kompetente tek autoritetet e duhura të Palës që ka paraqitur kërkesën dhe përgjigjet mund të kthehen direkt nga këto autoritete. Kërkesat e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj Konvente do të nisen nga Ministria e Drejtësisë e Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë të Palës së kërkuar.

6. Kërkesat për kopjet e dënimeve dhe të masave që parashikohen në nenin 4 të Protokollit Shtesë të Konventës mund të bëhen direkt nga autoritetet kompetente. Cilido Shtet Kontraktues, mund, në çdo kohë, me anë të një deklaratë adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të përkufizojë cilat autoritete do të konsiderohen për qëllimet e këtij paragrafi si autoritete kompetente.

7. Në raste urgjente, kur transmetimi direkt lejohet përmes kësaj Konvente, mund të kryhet nëpërmjet organizatës ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

8. Cilado Palë mund, në çdo kohë, me anë të një deklaratë adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë të drejtën për bërjen e ekzekutimit të kërkesës ose kërkesave specifike për asistencë reciproke, në varësi të një ose më shumë kushteve të mëposhtme:

a) që një kopje e kërkesës t'i niset autoritetit qendror të përcaktuar me anë të një deklaratë;

b) që kërkesat, duke përjashtuar kërkesat urgjente, t'i nisen autoritetit qendror, të përcaktuar në atë deklaratë;

c) që, në rast të transmetimit direkt për arsye urgjente, një kopje do t'i transmetohet në të njëjtën kohë Ministrisë së Drejtësisë;

d) që disa ose të gjitha kërkesat për asistencë t'i dërgohen nëpërmjet rrugëve të tjera nga ato që janë parashikuar në këtë nen.

9. Kërkesat për asistencë reciproke dhe çdo komunikim tjetër, bazuar në këtë Konventë ose Protokollin e saj, mund të nisen përmes rrugës elektronike ose formave të tjera të telekomunikimit, me kusht që Pala kërkuese është përgatitur, bazuar në kërkesë, të paraqesë në çdo kohë një dokument me shkrim të saj, si dhe origjinalin. Megjithatë, cilido Shtet Kontraktues, me anë të një deklaratë adresuar në çdo kohë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, vendos kushtet sipas të cilave do të pranojë dhe ekzekutojë kërkesat e marra në rrugë elektronike ose në mënyra të tjera telekomunikuese.

10. Dispozitat e këtij neni nuk paragjykojnë marrëveshjet ose rregullimet bilaterale në fuqi midis Palëve, të cilat parashikojnë transmetimin direkt të kërkesave për asistencë midis autoriteteve të tyre respektive.”.

Neni 5 Shpenzimet

Neni 20 i Konventës do të zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

“1. Palët nuk do të pretendojnë kundrejt njëra-tjetrës rimbursimin e ndonjë shpenzimi si rezultat i aplikimit në bazë të kësaj Konvente ose protokollit të saj, përveç:

a) shpenzimeve, si rezultat i pjesëmarrjes së ekspertëve në territorin e Palës që ka paraqitur kërkesën;

b) shpenzimeve, si rezultat i transferimit të një personi të paraburgosur në bazë të neneve 13 dhe 14 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Marrëveshjeje;

c) shpenzime esenciale ose të jashtëzakonshme.

2. Megjithatë, nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, shpenzimet për vendosjen e një lidhjeje me video ose telefon, shpenzimet lidhur me vënien në shërbim të një lidhjeje me video ose telefon Palës që ka paraqitur kërkesën, pagesat për përkthyesit dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet e udhëtimit për të shkuar tek Pala që ka paraqitur kërkesën do t'i disbursohen Palës së kërkuar nga Pala që ka paraqitur kërkesën.

3. Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën, me qëllim që të bien dakord për pagesat e shpenzimeve që pretendohen sipas paragrafit 1.c të sipërpërmendur.

4. Dispozitat e këtij neni do të aplikohen pa paragjykuar dispozitat e nenit 10 paragrafi 3 të kësaj Konvente.”.

Neni 6

Autoritetet gjyqësore

Neni 20 i Konventës do të zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

“Çdo Shtet, në kohën e firmosjes ose kur depoziton dokumentin e tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aksesimit, me anë të një deklaratë të adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës do të përkufizojë se cilët autoritete do të konsiderojë si autoritete gjyqësore për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Më vonë mund, në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, të ndryshojnë dispozitat e deklaratës së tij.”.

KAPITULLI 2

Neni 7

Shtyrja e ekzekutimit të kërkesave

1. Pala që ka paraqitur kërkesën mund të shtyjë veprimin, bazuar në një kërkesë të tillë nëse veprimi mund të paragjykojë procesin hetimor, ndjekjen penale ose procedura të tjera të lidhura të ndërmarra nga autoritetet.

2. Para refuzimit ose shtyrjes së ndihmës, Pala që ka bërë kërkesën, kur është e mundur pasi është konsultuar me Palën kërkuese, do të konsiderojë nëse kërkesa mund të miratohet pjesërisht ose duke paraqitur kushte që i konsideron të nevojshme.

3. Nëse kërkesa shtyhet, duhet të paraqiten arsyet për shtyrjen, Pala që ka paraqitur kërkesën informon Palën kërkuese për ndonjë arsye që e bën të pamundur ekzekutimin e kërkesës ose që mund të vonojë kërkesën në mënyrë për një kohë të gjatë.

Neni 8

Procedura

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 5, kur kërkesat specifikojnë formalitete ose procedura të cilat janë të domosdoshme sipas ligjit të Palës kërkuese, megjithëse të panjohur për Palët që kanë paraqitur kërkesën, kjo e fundit do të zbatohet kërkesa të tilla deri në atë masë sa që veprimi i kërkuar nuk bie ndesh me parimet themelore të ligjit të tij, derisa e kundërta nuk parashikohet në këtë Protokoll.

Neni 9

Proceset e dëgjimit me video

1. Nëse një person është në territorin e njëres Palë dhe duhet të marrë pjesë si dëshmitar ose ekspert në çështjet gjyqësore të Palës tjetër, kjo e fundit mund, kur nuk është e dëshiruar ose e mundur për personin, të paraqitet në territorin në fjalë personalisht, të kërkojë që procesi të zhvillohet me video - konferencë, siç parashikohet në paragrafët 2-7.

2. Pala që e ka paraqitur kërkesën bie dakord për zhvillimin e procesit me video-konferencë, me kusht që përdorimi i video-konferencës nuk bie ndesh me parimet e ligjit të saj dhe me kusht që posedon infrastrukturën teknike për zhvillimin e procesit.

Nëse Pala që ka paraqitur kërkesën nuk disponon infrastrukturën teknike për zhvillimin e procesit në video, konferencë, një infrastrukturë e tillë mund t'i vihet në dispozicion nga Pala kërkuese me anë të një marrëveshjeje.

3. Kërkesa për zhvillimin e procesit me video-konferencë do të përmbajë, përveç informacionit të referuar në nenin 14 të Konventës, arsyen pse nuk është e dëshiruar ose e mundur për dëshmitarin ose ekspertin pjesëmarrja personalisht, emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave që do të zhvillojnë procesin gjyqësor.

4. Autoriteti gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën do t'i nisë urdhëresë gjyqësore personit në fjalë për t'u paraqitur sipas procedurave që përmban ligji i saj.

5. Përsa i përket proceseve me video-konferencë, do të aplikohen rregullat e mëposhtme:

a) Një autoritet gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën do të jetë prezent gjatë procesit, do të jepet ndihma e përkthyesit nëse është nevoja dhe do të jetë përgjegjës për të bërë të mundur identifikimin e personit pjesëmarrës dhe respektimin e parimeve thelbësore të ligjit të Palës kërkuese.

Nëse autoriteti gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën është i mendimit që, për gjatë procesit, parimet themelore të ligjit të Palës që ka paraqitur kërkesën janë nëpërkëmbur, do të marrë në mënyrë të menjëhershme masa të nevojshme për të bërë të mundur vazhdimin e procesit sipas parimeve të sipërpërmendura.

b) Masat për mbrojtjen e personit pjesëmarrës në proces do të ndërmerren kur është e nevojshme me miratimin e autoriteteve kompetente të Palëve kërkuese dhe të kërkuara.

c) Procesi zhvillohet drejtpërsëdrejti ose nën drejtimin e autoritetit gjyqësor të Palës kërkuese në përputhje me ligjet e saj.

d) Me kërkesë të Palës kërkuese ose të personit pjesëmarrës në proces, Pala që ka paraqitur kërkesën do të bëjë të mundur që personi pjesëmarrës në proces të asistohet nga një përkthyes nëse lind nevoja.

e) Personi pjesëmarrës në proces mund të ushtrojë të drejtën e tij për të mos dëshmuar, e cila i lind atij ose asaj sipas ligjit të Palës që i është paraqitur kërkesa ose të Palës kërkuese.

6. Pa paragjykuar masat e rëna dakord për mbrojtjen e personave, autoriteti gjyqësor i Palës që i është paraqitur kërkesa, në përfundim të procesit do të dokumentojë minutat, të konfirmojë datën dhe vendin e zhvillimit të procesit, identitetin e personit pjesëmarrës, identitetin dhe funksionet e të gjithë personave të Palës që i është paraqitur kërkesa, pjesëmarrës në këtë proces, të hetimeve të bëra dhe të kushteve teknike nën të cilat është zhvilluar procesi. Dokumenti do të nisët nga autoriteti kompetent i Palës që ka paraqitur kërkesën autoritetit kompetent të Palës kërkuese.

7. Çdo Palë duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që në rastet kur dëshmitarët ose ekspertët që merren në pyetje brenda territorit të tyre, nën detyrimin për të dëshmuar në përputhje me këtë nen dhe refuzojnë të dëshmojnë ose nuk dëshmojnë të vërtetën, të zbatohet legjislacioni i tyre kombëtar në të njëjtën mënyrë, sikundër do të ndodhte nëse marrja në pyetje (dëgjimi) të bëhej sipas procedurave kombëtare.

8. Palët nën diskrecionin e tyre mund të zbatojnë parashikimet e këtij neni, në përputhje dhe në marrëveshje me autoritetet kompetente gjyqësore dhe në rastet e seancave gjyqësore me video-konferencë. Në këtë rast, vendimi për të mbajtur vide-konferencën, si dhe përcaktimi i mënyrës se si do të zhvillohet video-konferenca duhet të jenë subjekt i marrëveshjes ndërmjet Palëve të interesuara, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, si dhe me instrumentet e përshtatshme ndërkombëtare. Seancat e dëgjimit, që kanë të bëjnë me personin e akuzuar apo të dyshuar, do të zhvillohen me miratimin e tij ose të saj.

9. Çdo Shtet Kontraktues, në çdo kohë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duhet të deklarojë se nuk do të përdorë mundësinë e ofruar në paragrafin 8 për aplikimin e parashikimeve të këtij neni për rastet e zhvillimit të seancave me video-konferencë, ku përfshihet dhe personi i akuzuar ose i dyshuar.

Neni 10

Seancat e dëgjimit me anë të konferencave telefonike

1. Nëse një person ndodhet në territorin e një Pale dhe do të dëgjohet në seancë gjyqësore prej një organi gjyqësor të një Pale tjetër në cilësinë e një dëshmitari ose eksperti, mundet që, në rastet kur legjislacioni i tij kombëtar e parashikon, të kërkojë ndihmën e Palës së mëparshme për të bërë të mundur zhvillimin e seancës së dëgjimit me anë të konferencave telefonike, sikundër është parashikuar në paragrafët nga 2-6.

2. Seanca dëgjimore mund të zhvillohet me anë të konferencave telefonike, vetëm në rast se dëshmitari ose eksperti bie dakord për zhvillimin e seancës dëgjimore me këtë metodë.

3. Pala e kërkuar duhet të japë miratimin e tij për zhvillimin e seancës dëgjimore, me anë të konferencave telefonike, në rastet kur kjo nuk është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit të vet.

4. Kërkesa për konferenca telefonike duhet të përmbajë, në vijim të informacionit të cilit i referohet në nenin 14 të Konventës, emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave të cilët do të drejtojnë seancën dëgjimore, si dhe të përmbajë një përcaktim që dëshmitari ose eksperti është i gatshëm për të marrë pjesë në një seancë me konferencë telefonike.

5. Palët duhet të bien dakord për çështjet praktike që kanë të bëjnë me seancën dëgjimore. Në rast se bien dakord për rregullime të tilla, Pala e kërkuar duhet:

a) të njoftojë dëshmitarin ose ekspertin për kohën dhe vendin e zhvillimit të seancës së dëgjimit;

b) të sigurojë identitetin e dëshmitarit ose ekspertit;

c) të verifikojë nëse dëshmitari ose eksperti bien dakord për zhvillimin e seancës me anë të mbledhjes telefonike.

6. Pala e kërkuar mund të bëjë tërësisht ose pjesërisht marrëveshjen, subjekt të parashikimeve përkatëse të nenit 9 paragrafi 5 dhe 7.

Neni 11

Informacioni spontan

1. Pa paragjykuar hetimet ose procedurat ekzistente, autoritetet kompetente të një Pale mundet që, pa nevojën e një kërkesë paraprake, të nisin për autoritetet kompetente të Palës tjetër informacionin e përfituar brenda kuadrit të hetimeve të kryera nga ana e tyre, kur ata vlerësojnë që zbardhja e informacionit mund të asistojë Palën marrëse në fillimin ose zbatimin e procedurave ose hetimeve që mund të çojë në një kërkesë bazuar në Konventën ose Protokollin e saj, nënshkruar nga ajo Palë.

2. Pala që siguron informacionet mundet që, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, të vendosë kushte për përdorimin e informacioneve të tilla për Palën që i merr këto informacione.

3. Pala që i merr këto informacione duhet t'u përmbahet këtyre kushteve.

4. Çdo Shtet Kontraktues mundet që në çdo kohë, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën për të mos iu përmbajtur këtyre kushteve të vendosura nga Pala që siguron informacionin sipas paragrafit 2 të mësipërm, përveç rasteve kur ai merr njoftim paraprak për natyrën e informacionit që do të sigurohet dhe bie dakord për transmetimin e tij.

Neni 12

Kthimi

1. Me kërkesë të Palës kërkuese dhe pa paragjykuar të drejtat e Palëve të treta në bona fide (mirëbesim), Pala e kërkuar mund të vendosë në dispozicion të Palës kërkuese objekte të marra me mënyra jo ligjore, me synim për t'ia kthyer pronarëve të tyre të ligjshëm.

2. Në zbatim të neneve 3 dhe 6 të Konventës, Pala e kërkuar mund të heqë dorë nga një aplikim i neneve si para, ashtu dhe pasi i janë dhënë Palës kërkuese, nëse aplikimi i neneve të tilla për pronarin e tyre të ligjshëm mund të lehtësohen nga kjo. Të drejtat e palëve të treta në bona fide nuk do të preken nga kjo.

3. Në rastin e heqjes dorë nga aplikimi i neneve, para se ato t'i kalojnë Palës kërkuese, Pala e kërkuar nuk do të ushtrojë të drejtën e sigurimit ose të drejtë tjetër rekursi të parashikuar në legjislacionin e taksave ose doganave në zbatim të këtyre neneve.

4. Një heqje dorë, sikundër është referuar në paragrafin 2, nuk do të ketë të bëjë me paragjykim të së drejtës së Palës së kërkuar për të mbledhur taksa ose detyrime të tjera tatimore nga pronari i ligjshëm.

Neni 13

Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar për tek Palët e kërkuara

1. Në se ka një marrëveshje midis autoriteteve kompetente të Palëve në fjalë, një Palë e cila ka kërkuar një hetim për të cilin kërkohet prezenca e personit të mbajtur në paraburgim në territorin e saj mund të transferojë përkohësisht atë person në territorin e Palës ku bëhet hetimi.

2. Marrëveshja do të mbulojë rregullimet për transferimin e përkohshëm të personit dhe datën në të cilën personi duhet të kthehet në territorin e Palës kërkuese.

3. Kur kërkohet miratimi i personit për transferimin, një dëshmi miratimi ose një kopje e saj duhet t'i dërgohet Palës së kërkuar.

4. Personi i transferuar do të mbetet në paraburgim në territorin e Palës së kërkuar dhe, kur aplikohet, në territorin e Palës në të cilën kërkohet kalimi tranzit, përveç rastit kur Pala nga e cila personi është transferuar kërkon lirimin e tij/e saj.

5. Periudha e paraburgimit në territorin e Palës së kërkuar do të reduktohet nga periudha e mbajtjes, të cilën personi në fjalë është ose do të jetë i detyruar ta kalojë në territorin e Palës kërkuese.

6. Dispozitat e nenit 11 paragrafi 2 dhe nenit 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis.

7. Çdo Shtet Kontraktues mund, në çdo kohë, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që para se të arrihet një marrëveshje nën paragrafin 1 të këtij neni, kërkohet miratimi, të cilit i referohet paragrafi 3 i këtij neni, ose do të kërkohet nën kushte të veçanta të bëra në deklaratë.

Neni 14

Paraqitja personale e personit të caktuar për transferim

Dispozitat e nenit 11 dhe 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis edhe ndaj personave të cilët janë në paraburgim në territorin e Palës së kërkuar, që janë transferuar në mënyrë që të vuajnë një dënim të dhënë në Palën kërkuese, ku paraqitja personale për efekt të rishikimit të gjyqësorit është kërkuar nga Pala kërkuese.

Neni 15

Gjuha e dokumenteve procedurale dhe vendimeve gjyqësore të nevojshme

1. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen për çdo kërkesë për shërbim në nenin 7 të Konventës ose nenit 3 të Protokollit Shtesë.

2. Dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore, në çdo rast, do të transmetohen në gjuhën ose gjuhët në të cilën ato janë lëshuar.

3. Paravarësisht nga dispozitat e nenit 16 të Konventës, nëse autoriteti që ka lëshuar dokumentet di ose ka arsye të besojë se adresati kupton vetëm ndonjë gjuhë tjetër, dokumentet ose të paktën pjesët më të rëndësishme do të shoqërohen me një përkthim në atë gjuhë tjetër.

4. Pavarësisht dispozitave të nenit 16 të Konventës, dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore, për të mirën e autoriteteve të Palës së kërkuar, do të shoqërohen nga një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së tyre e përkthyer në gjuhën ose një nga gjuhët e asaj Pale.

Neni 16 **Shërbimi me postë**

1. Autoritetet gjyqësore të ndonjë Pale mund t'u drejtohen direkt, me postë, dokumente procedurale dhe vendime gjyqësore, personave të cilët janë në territorin e ndonjë Pale tjetër.

2. Dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore do të shoqërohen nga një raport i cili të përcaktojë se adresati mund të marrë informacion nga autoriteti i identifikuar në raport për të drejtat e tij/të saj dhe detyrimet lidhur me shërbimin e dokumenteve. Dispozitat e paragrafit 3 të nenit 15 do të zbatohen për atë raport.

3. Dispozitat e nenit 8, 9 dhe 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis ndaj shërbimit me postë.

4. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 15 më sipër, gjithashtu, do të zbatohen ndaj shërbimit me postë.

Neni 17 **Mbikëqyrje ndërkuftare**

1. Oficerët e policisë të njëres nga Palët që, në kuadrin e një hetimi penal, do të mbikëqyrin në vendin e tyre një person që prezumohet të ketë marrë pjesë në një vepër penale, ndaj të cilës mund të zbatohet ekstradimi, ose një person ndaj të cilit ka arsye të forta për të besuar se do të çojë në identifikimin ose vendndodhjen e personit të sipërpërmendur, do të autorizohen të vazhdojnë mbikëqyrjen e tyre në territorin e Palës tjetër, kur kjo e fundit ka autorizuar mbikëqyrjen ndërkuftare në përgjigje të një kërkesë për asistencë, e cila është dorëzuar më parë. Kushtet mund t'i bashkëngjiten autorizimit.

Sipas kërkesës, mbikëqyrja do t'ju besohet oficerëve të Palës, në territorin e të cilës kryhet mbikëqyrja.

Kërkesa për asistencë sipas nënparagrafit të parë duhet t'i dërgohet një autoriteti të caktuar nga secila Palë dhe që ka juridiksion të japë ose të nisë autorizimin e kërkuar.

2. Kur, për arsye të veçanta urgjence, autorizimi paraprak i Palës tjetër nuk mund të kërkohet, oficerët që kryejnë mbikëqyrjen në kuadrin e një hetimi penal do të autorizohen të vazhdojnë mbikëqyrjen përtej kufijve të një personi që prezumohet të ketë kryer vepër penale të përcaktuar në paragrafin 6, duke u siguruar që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Autoritetet e Palës të caktuar nën paragrafin 4, në territorin e së cilës do të vazhdojë mbikëqyrja, duhen njoftuar menjëherë, gjatë mbikëqyrjes, që kufiri është kaluar.

b) Do të dorëzohet pa asnjë vonesë një kërkesë për asistencë sipas paragrafit 1 dhe që nënvizon arsyet për kalimin e kufirit pa autorizim.

Mbikëqyrja do të përfundojë sapo Pala në territorin e së cilës është duke u kryer kjo mbikëqyrje e kërkon këtë gjë, pas njoftimit të referuar në pikën a ose kërkesës së referuar në pikën b ose atje ku autorizimi nuk është marrë brenda një kohe prej 5 orësh pas kalimit të kufirit.

3. Mbikëqyrja e referuar në paragrafët 1 dhe 2 do të kryhet vetëm sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) Organi i policisë që kryen mbikëqyrjen duhet të ndjekë dispozitat e këtij neni dhe ligjin e Palës, në territorin e së cilës po operohet; ata (policët) duhet t'i binden udhëzimeve të organeve përgjegjëse lokale.

b) Përveç situatave të parashikuara në paragrafin 2, gjatë kohës së mbikëqyrjes, policët do të mbajnë me vete një dokument që vërteton se autorizimi është dhënë.

c) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen duhet të jenë në gjendje gjatë të gjithë kohës të provojnë që ata po veprojnë me autoritet zyrtar.

d) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen mund të mbajnë armët e tyre gjatë kësaj mbikëqyrjeje, përveç, sigurisht, kur vendoset ndryshe nga Pala e kërkuar; përdorimi i armëve do të jetë i ndaluar përveç rasteve të vetëmbrojtjes.

e) Hyrja në shtëpi private dhe vende të pacaktuara për publikun është e ndaluar.

f) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen nuk mund të ndalojnë ose të marrin në pyetje, dhe as të arrestojnë personin nën mbikëqyrje.

g) Të gjitha veprimet mund të raportohen tek autoritetet e Palës, në territorin e së cilës ato u kryen; policët që janë duke kryer mbikëqyrjen mund të kërkohen të shfaqen personalisht.

h) Kur kërkohet nga organet e Palës, në territorin e së cilës u krye mbikëqyrja, organet e Palës nga e cila kanë ardhur policët mbikëqyrës do të ndihmojnë në investigimin pas operacionit, në të cilin ato marrin pjesë, duke përfshirë edhe procedimet ligjore.

4. Gjatë kohës së firmosjes ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të Palëve, këto do të përcaktojnë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të dy policët dhe organet që ata zgjedhim për qëllimet e shprehura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, Palët mund të ndryshojnë termat e deklaratës së tyre.

5. Në një nivel bilateral, Palët mund të zgjerojnë hapësirën e këtij neni dhe të përshtasin masa të tjera në zbatimin e tij.

6. Mbikëqyrja e referuar në paragrafin 2 mund të ndodh vetëm për një nga krimet e mëposhtme:

- vrasje e një personaliteti publik;
- vrasje;
- përdhunim;
- djegie prone;
- falsifikim;
- vjedhje me armë dhe pranimi i mallrave të vjedhura;
- kërcënim për të marrë paratë;
- rrëmbim dhe marrje peng;
- trafikim njerëzish;
- trafikim i paligjshëm, i narkotikëve dhe substancave psikoterapike;
- përdorim eksplozivësh;
- mbartja e paligjshme e mbetjeve toksike dhe të rrezikshme;
- trafikim i të huajve;
- abuzim seksual i fëmijëve.

Neni 18

Dorëzim i kontrolluar

1. Çdo Palë merr përsipër të sigurojë që, pas kërkesës së një Pale tjetër, dorëzimet e kontrolluara mund të lejohen në territorin e saj në kuadrin e investigimeve penale mbi krimet e ekstradueshme.

2. Vendimi për të kryer dorëzime të kontrolluara do të merret sipas çdo rasti nga organet kompetente të Palës së kërkuar, duke marrë parasysh të drejtën kombëtare të asaj Pale.

3. Dorëzimet e kontrolluara do të bëhen në përputhje me procedurat e Palës së kërkuar. Kompetenca për të vepruar, drejtuar dhe kontrolluar operacionet do të jetë mbi organet kompetente të asaj Pale.

4. Në kohën e firmosjes ose depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, Palët do të përcaktojnë organet që janë kompetente sipas këtij neni. Ato mund, në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, të ndryshojnë kushtet e deklaratës së tyre.

Neni 19
Hetimet sekrete

1. Palët kërkuese dhe të kërkuara mund të bien dakord të asistojnë njëra-tjetrën në kryerjen e hetimeve të krimeve me anë të policëve që veprojnë me identitet të fshehur, (investigimet sekrete).

2. Vendimi mbi kërkesën merret për çdo rast me anë të organeve kompetente të Palës së kërkuar, duke marrë në konsideratë të drejtën dhe procedurat kombëtare. Zgjatja e investigimit sekret, kushtet e detajuara, dhe statusi ligjor i policëve të përfshirë në investigimet sekrete do të negociohen midis Palëve, duke marrë parasysh procedurat dhe të drejtën kombëtare.

3. Hetimet sekrete do të bëhen në përputhje me procedurat dhe të drejtën kombëtare të Palës në territorin e së cilës bëhet investigimi sekret. Palët e përfshira do të bashkëpunojnë për të siguruar që investigimi sekret të përgatitet dhe mbikëqyret dhe për të bërë rregullime për sigurimin e policëve që veprojnë me identitet të fshehur ose fals.

4. Gjatë kohës së firmosjes ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të Palëve, këto do të përcaktojnë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës organet kompetente për qëllimet e shprehura në paragrafin 2 të këtij neni. Në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, Palët mund të ndryshojnë termat e deklaratës së tyre.

Neni 20
Skuadrat e hetimeve të përbashkëta

1. Me anë të një marrëveshjeje të përbashkët, organet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të ngrejnë një skuadër të përbashkët investigimi për një qëllim specifik dhe për një periudhë të kufizuar, që edhe mund të zgjatet me anë të rakordimit të përbashkët, për të kryer investigime penale në një ose më shumë nga Palët që ngrejnë skuadrën. Përbërja e skuadrës do të vendoset në marrëveshje.

Një investigim i përbashkët mund të ngrihet, veçanërisht, kur:

a) investigimet e një Pale mbi krimet e rënda kërkojnë që investigimet e vështira të kenë lidhje me Palë të tjera;

b) një numër Palësh janë duke kryer investigime mbi krimet e rënda, në të cilat rrethanat e çështjes sjellin nevojën e veprimit të koordinuar dhe të përqëndruar nga Palët e përfshira.

Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi mund të bëhet nga çdo Palë përkatëse. Skuadra do të ngrihet në një nga Palët e parashikuara për të kryer investigim.

2. Përveç informacionit të referuar në dispozitat relevante të nenit 14 të Konventës, kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi do të përfshijnë propozime për përbërjen e skuadrës.

3. Një skuadër e përbashkët investigimi do të operojë në territorin e Palëve që formojnë skuadrën nën kushtet e përgjithshme si më poshtë:

a) Një udhëheqës skuadre do të jetë një përfaqësues i organit kompetent që merr pjesë në investigimet penale nga Pala në të cilën skuadra vepron. Kryetari i grupit do të veprojë brenda kufijve të kompetencës së tij ose të saj, sipas legjislacionit të vendit.

b) Grupi duhet të ushtrojë veprimet e tij në përputhje me ligjin e Palës në të cilën vepron. Anëtarët dhe anëtarët e bashkëngjitur të grupit do të kryejnë detyrat e tyre nën udhëheqjen e personit që i referohet nënparagrafi a, duke marrë në konsideratë kushtet e vendosura nga autoritetet e tyre në marrëveshjen e krijimit të grupit.

c) Pala në të cilën grupi vepron do të bëjë përgatitjet e duhura organizuese për të vepruar kështu.

4. Në këtë nen, pjesëtarët e grupit të përbashkët hetues nga Pala në të cilën grupi vepron janë referuar si "anëtarë", ndërkohë që anëtarët nga Palët ndryshe nga Pala në të cilën grupi vepron janë të referuara si "Palë të bashkëngjitura".

5. Palët e bashkëngjitura të grupit të përbashkët hetues do të kenë të drejtën të jenë të pranishme kur të ndërmerren masa hetimore në Palën në të cilën veprohet. Megjithatë, kryetari i grupit, për raste të veçanta, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, mund të vendosë ndryshe.

6. Anëtarëve të bashkëngjitur të grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, t'u besohet nga kryetari i grupit me detyrën e ndërmarrjes të masave të veçanta hetimore kur kjo është aprovuar nga autoritetet kompetente të Palës ku kryhen veprimet dhe të Palës së bashkëngjitur.

7. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme të ndërmerren masa hetimore në një nga Palët që ka krijuar grupin, anëtarët e bashkëngjitur të grupit nga kjo Palë mund të kërkojnë që të jenë autoritetet e veta kompetente të ndërmarrin këto masa. Këto masa do të konsiderohen në atë Palë, sipas kushteve në të cilat mund të aplikohet nëse do të kërkoheshin në një hetim kombëtar (brenda vendit).

8. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme ndihmën nga një Palë ndryshe nga Palët të cilat kanë krijuar grupin ose nga një Shtet i tretë, kërkesa për ndihmë mund të bëhet nga autoritetet kompetente të shtetit ku veprohet për autoritetet kompetente të Shtetit tjetër të interesuar në përputhje me instrumentet ose përgatitjet përkatëse.

9. Një anëtar i bashkëngjitur i grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e saj ose të tij kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencës së saj ose të tij, t'i sigurojë grupit informacion që gjendet në Palën që i bashkëngjitet atij ose, asaj me qëllim kryerjen e hetimeve kriminale nga grupi.

10. Informacioni i siguruar në rrugë ligjore nga një anëtar ose një anëtar i bashkëngjitur ndërkohë që një pjesë e grupit të përbashkët hetimor, i cili nuk është ndryshe (në të kundërt) i gatshëm për autoritetin kompetent të Palëve të interesuara mund të shfrytëzohet për qëllimet e mëposhtme:

- a) për qëllimet për të cilat grupi është krijuar;
- b) në lidhje me pëlqimin e dhënë më parë nga Pala e cila dha informacionin për kapjen, hetimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale; ky pëlqim mund të jepet vetëm në rastet ku përdorimi i tillë do të rriste rrezikun për hetime kriminale nga Pala e interesuar apo që lidhet me të, atëherë Pala do të refuzojë ndihmën reciproke.
- c) për të parandaluar një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike dhe pa paragjykim në paragrafin b, nëse hapet përsëri një hetim penal (kriminal);
- d) për qëllime të tjera, në lidhje me atë që është rënë dakord mes Palëve, do të ngrihet një grup.

11. Ky nen do të jetë pa paragjykim për çdo dispozitë apo rregullim të ngritjes ose të veprimit të grupeve të përbashkëta të hetimeve.

12. Në lidhje me atë që shprehen ligjet e Palëve ose me dispozitat e çdo instrumenti të zbatueshëm ligjor që i lejon ata, mund të bihet dakord për rregullime për personat e ndryshëm nga ata përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve të përcaktuara në grupet e përbashkëta të hetimeve për të marrë pjesë në aktivitetet e këtij grupi. Të drejtat që gëzojnë anëtarët apo zëvendësuesit e anëtarëve të grupit, siç parashikohet në këtë, nuk do të gëzohen nga këta persona për sa kohë nuk është rënë dakord dhe deklarohet e tillë.

Neni 21

Përgjegjësia penale e zyrtarëve

Gjatë veprimeve të referuara në nenet 17, 18, 19 ose 20, përveç rasteve kur vetë Palët kanë rënë dakord ndryshe, zyrtarët e Palës, të ndryshme nga Pala e veprimit, konsiderohen si zyrtarë të Palës së veprimit, në lidhje me krimet e kryera kundër tyre ose nga vetë ata.

Neni 22

Përgjegjësia civile e zyrtarëve

1. Në zbatim të neneve 17, 18, 19 ose 20, kur zyrtarët e një Pale vepron pranë Palës tjetër, Pala e parë është përgjegjëse për çdo dëm që mund të shkaktohet gjatë veprimeve, në përputhje me ligjin e Palës, në territorin e së cilës vepron.

2. Pala, në territorin e së cilës shkaktohet dëmi i referuar në paragrafin 1, zbaton ndaj tij të njëjtat dispozita të zbatueshme për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët e tij.

3. Pala, zyrtarët e së cilës kanë shkaktuar dëm ndaj personit në territorin e Palës tjetër, rimbursojnë çdo shumë që është paguar për viktimat ose personat që kanë vepruar në emër të tyre.

4. Pa paragjykim në ushtrimin e të drejtave të tyre ndaj Palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, secila Palë, në rastin e parashikuar në paragrafin 1, heq dorë nga kërkimi i rimbursimit të dëmit të pretenduar nga Pala tjetër.

5. Dispozitat e këtij neni janë subjekt i stimulimeve nëse Palët nuk bien dakord ndryshe.

Neni 23

Mbrojtja e dëshmitarëve

Nëse një Palë kërkon ndihmë, në bazë të Konventës ose njërit nga Protokollet e tij në lidhje me një dëshmitar të rrezikuar ose në nevojë për mbrojtje, autoritetet kompetente të Palës së kërkuar dhe kërkuese bien dakord për masat e mbrojtjes së personit të rrezikuar, në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm.

Neni 24

Masat provizore

1. Me kërkesë të Palës kërkuese, Pala e kërkuar, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, merr masa provizore për ruajtjen e provave, të situatës ekzistuese ose mbrojtjes së interesave ligjore të rrezikuar.

2. Pala e kërkuar mund ta zbatojë kërkesën në mënyrë të pjesshme ose me kushte brenda një kohe të kufizuar.

Neni 25

Konfidencialiteti

Pala kërkuese i kërkon Palës së kërkuar të ruajë sekretin e faktit dhe thelbit të kërkesës, deri në masën e nevojshme të zbatimit të kërkesës. Nëse Pala e kërkuar nuk është dakord me kërkesën e konfidencialitetit, ajo duhet të njoftojë menjëherë Palën kërkuese.

Neni 26

Mbrojtja e të dhënave

1. Të dhënat personale të transferuara nga një Palë tek tjetra si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së paraqitur në zbatim të Konventës ose njërit nga protokollet e saj, mund të përdoren nga Pala ku janë transferuar të dhënat vetëm:

a) për qëllime të procedurave, ndaj të cilave zbatohet Konventa ose një nga protokollet e saj;

b) për procedura të tjera gjyqësore ose administrative, që lidhen drejtpërdrejt me procedurat e përmendura në (a);

c) për parandalimin e një kërcënimi të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike.

2. Megjithatë, këto të dhëna mund të përdoren për çdo qëllim tjetër, nëse Pala që ka transferuar të dhënat, ka dhënë pëlqimin paraprak.

3. Secila Palë mund të refuzojë transferimin e të dhënave personale të marra si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së paraqitur në bazë të Konventës ose njërit nga protokollet e saj, kur:

- këto të dhëna mbrohen nga legjislacioni vendas; dhe
- Pala së cilës duhet t'i dërgohen të dhënat nuk ka kufizime nga Konventa mbi Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, bërë në Strasburg më 28.1.1981, për sa kohë që Pala në fjalë merr përsipër përballimin e mbrojtjes së këtyre të dhënave sikurse kërkohet nga Pala e parë.

4. Çdo Palë që dërgon të dhëna personale të marra si rezultat i zbatimit të një kërkesë të paraqitur në kuadër të Konventës ose të ndonjë protokollit të saj mund t'i kërkojë Palës së cilës i janë dërguar të dhënat t'i japë informacion mbi përdorimin e këtyre të dhënave.

5. Çdo Palë, mundet që me një deklaratë të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, brenda kuadrit të procedurave për të cilat mund të ketë refuzuar ose kufizuar transmetimin apo përdorimin e të dhënave personale bazuar në dispozitat e Konventës ose të ndonjë protokollit të saj, të kërkojë që të dhënat personale të dërguara një Pale tjetër të mos përdoren nga ky i fundit për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1, në qoftë se nuk është dhënë miraimi përkatës më parë.

Neni 27

Autoritetet administrative

Palët mundën në çdo kohë, me anë të një deklaratë të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të përcaktojnë autoritete administrative për qëllime e përcaktuara në nenin 1 paragrafi 3 i Konventës.

LIGJ

Nr. 8884, datë 22.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7653, DATË 23.12.1992; NR.7723, DATË 21.6.1993; NR.7925, DATË 19.4.1995; NR.8159, DATË 7.11.1996 DHE NR.8333, DATË 23.4.1998

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925, datë 19.4.1995; nr.8159, datë 7.11.1996 dhe nr.8333, datë 23.4.1998, fjalët Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002.

Shpallur me dekretin nr.3317, datë 30.4.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8885, datë 22.4.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 “PËR TRANSFORMIMIN
E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE”, NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.8067, DATË 15.2.1996; NR.8099, DATË 28.3.1996; NR.8158, DATË 7.11.1996;
NR.8237, DATË 1.9.1997; NR.8482, DATË 10.5.1999 DHE ME DEKRETET NR.1195, DATË
14.8.1995 DHE NR.1615, DATË 20.9.1996**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me ligjin nr.8067, datë 15.2.1996; nr.8099, datë 28.3.1996; nr.8158, datë 7.11.1996; nr.8237, datë 1.9.1997; nr.8482, datë 10.5.1999 dhe me dekretet nr.1195, datë 14.8.1995 dhe nr.1615, datë 20.9.1996, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Hiqet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë tregtare që janë në juridiksionin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit emërohen nga Ministri i kësaj Ministerie.”

Paragrafi i katërt ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Ekonomisë, por 2/3 e anëtarëve të Këshillit propozohen nga ministrinë dhe institucionet përkatëse që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002.

Shpallur me dekretin nr.3318, datë 30.4.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8886, datë 22.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8334, DATË 23.4.1998 “PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 2 Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002.

Shpallur me dekretin nr.3319, datë 30.4.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8887, datë 22.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8306, DATË 14.3.1998 “PËR STRATEGJINË E PRIVATIZIMIT TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8459, DATË 11.2.1999 DHE LIGJIN NR.8582, DATË 23.2.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me ligjin nr.8459, datë 11.2.1999 dhe ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002.

Shpallur me dekretin nr. 3320, datë 30.4.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM

Nr. 149, datë 25.4.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.154, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR LICENCIMIN E VEPRIMTARIVE PRODHUESE NË INDUSTRIJË
JOSHQIMORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 15 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 dhe 9 të vendimit nr.154, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin e veprimtarive prodhuese në industrinë joshqimore", emërtimi "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohet me "Ministria e Industrisë dhe Energjetikës".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**

VENDIM

Nr. 151, datë 25.4.2002

PËR STATUSIN "DËSHMOR I ATDHEUT"

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, 13 dhe 20 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut" dhe të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. a) Përbërja e Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" pranë Këshillit të Ministrave, është si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------|
| - Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale | Kryetar |
| - Zëvendësministri i Mbrojtjes | Nënkryetar |
| - Zëvendësministri i Drejtësisë | Anëtar |
| - Zëvendësministri i Rendit Publik | Anëtar |
| - Zëvendësministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit | Anëtar |
| - Dy përfaqësues të shoqatës së familjeve të dëshmorëve të LANÇ-it | anëtarë. |

b) Emërtimit të strukturës ekzistuese të veteranëve dhe invalidëve të LANÇ-it, "Departamenti i Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës" t'i shtohet edhe "...dhe të Dëshmorëve të Atdheut".

Stafi teknik i "Departamentit të Veteranëve dhe Invalidëve të LANÇ-it" në Ministrinë e Mbrojtjes do të kryejë edhe detyrat e stafit teknik të Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut".

c) Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" mbledhet një herë në muaj.

Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit për pjesëmarrjen në mbledhje është 3000 (tre mijë) lekë.

Në rast shërbimi për çështje të vërtetimit të kërkesave për statusin "Dëshmor i Atdheut" dhe për pjesëmarrje në ceremoni varrimi, anëtari i Komisionit merr dietë, sipas vendit të punës.

Anëtarët e komisionit, përfaqësues të shoqërisë civile, marrin dietë të bazuar në pagën e zëvendësministrit.

Pagesa e dietave për shërbim dhe pagesat për pjesëmarrje në mbledhje të komisionit bëhen nga Ministria e Mbrojtjes.

2. a) Kërkesa për shpalljen "Dëshmor i Atdheut" përmban identitetin, e plotë dhe të saktë, të të rënit, një jetëshkrim të tij dhe përshkrimin e saktë të luftimit apo të rrethanave të ngjarjes ku ka mbetur i vrarë, sipas dokumenteve zyrtare, shtetërore, dhe i paraqitet Këshillit të Qarkut. Këshilli i Qarkut pas shqyrtimit e përcjell kërkesën, së bashku me dokumentet e lartpërmendura, në Departamentin e Veteranëve të Invalidëve të LANÇ-it dhe të Statusit "Dëshmor i Atdheut" në Ministrinë e Mbrojtjes për Komisionin Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut".

b) Kërkesa për njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut" shoqërohet me certifikatën e gjendjes civile të të rënit dhe me certifikatën e trungut të tij familjar.

Në emër të familjes kërkesën e paraqet njëri nga pjesëtarët e saj, bashkëshorti ose bashkëshortja, fëmijët (më i madhi), prindërit (nëna, babai), vëllezërit dhe motrat (më i madhi ose më e madhja).

c) Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve përkatëse, merr vendim për njohjen ose jo të këtij statusi dhe njofton të interesuarin.

ç) Kur familja e "Dëshmorit të Atdheut" paraqet vendimin e organit shtetëror, me statusin me të cilin personi është shpallur "Dëshmor i Atdheut" Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" njihet me dokumentet e paraqitura, nga familja ose institucionet e përcaktuara në ligj, dhe, pasi e gjen të saktë shpalljen "Dëshmor i Atdheut", merr vendimin përkatës për dhënien familjes së simbolit "Familje e Dëshmorit të Atdheut". Ky simbol i dërgohet familjes jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes së vendimit, së bashku me dokumentin për shpërblim mujor.

a) Varrimi i "Dëshmorit të Atdheut" në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, në kryeqytet, bëhet me vendim të Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut".

b) Varrimi i "Dëshmorit të Atdheut" organizohet nga prefekti dhe Këshilli i Qarkut, të cilët caktojnë edhe një komision për ceremoninë.

Për varrimin e ish-ushtarakëve të Forcave të Armatosura dhe të efektivave të Ministrisë së Rendit Publik, që shpallen "Dëshmor i Atdheut", zbatohen rregulloret e ceremonialit të këtyre institucioneve.

Institucionet e tjera, të interesuara drejtëpërdrejt, ndihmojnë organet e pushtetit vendor për organizimin dhe zhvillimin e ceremonisë.

c) Ceremoniali i varrimit të "Dëshmorit të Atdheut" përmban këto elemente:

- vendosjen për homazhe të arkivolit në një mjedis publik të Bashkisë a Këshillit të Qarkut, të një institucioni kulturor ose të institucionit ku ka shërbyer "Dëshmori i Atdheut";

- arkivoli mbulohet me Flamurin Kombëtar, orkestra frymore ekzekuton muzikë funebër dhe Himn Kombëtar;

- truproje nderi, e nxjerrë nga komanda e garnizonit ushtarak;

- miting në sheshin e institucionit ku do të bëhen homazhe (ose në një shesh tjetër, të përshtatshëm, të afërt). Fjala e rastit nga përfaqësues të organeve shtetërore, familja dhe shoqëria civile.

- masa për sigurimin e ceremonisë;
- autobusë për transportimin e familjarëve.

ç) Shpenzimet e varrimit të "Dëshmorit të Atdheut" përfshijnë shpenzimet për arkivolin, për transportin, për qëndrimin në morg, për ceremoninë, për kurorat, për drekën (deri në 150 mijë lekë) dhe një ndihmë të menjëhershme për familjen, në masën e tri pagave minimale, në shkallë vendi. Shpenzimet përballohen nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe planifikohen në buxhetin vjetor të saj.

4. Këshillat e Qarqeve (Këshilli Bashkiak i Tiranës), çdo vit, në periudhën e planifikimit të buxhetit, i paraqesin Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit planin financiar për shpenzimet për varrim dhe për meremetimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve të Atdheut e të simboleve të Luftës në qarqet e tyre.

5. a) Shpërblimi financiar mujor për familjen e Dëshmorit të Atdheut caktohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë. Komisioni Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut" i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore listat e familjeve që përfitojnë shpërblimin, i cili merret nga familjari, i autorizuar për këtë qëllim nga përfituesit e këtij shpërblimi. Një kopje e vendimit të komisionit, për çdo rast, vendoset në dosjen përkatëse të Dëshmorit të Atdheut.

b) Shpërblimi i familjes së Dëshmorit të Atdheut jepet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas vendimit të Komisionit Qendror për Statusin "Dëshmor i Atdheut", certifikatës së gjendjes civile, familjare dhe personale.

c) Shpenzimet financiare për shpërblimin e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut për vitin 2002 do të jenë në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, të cilat janë parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në fondin e sigurimeve suplementare, në zërin e ri "Pagesat e familjeve të Dëshmorëve të Atdheut".

6. Efektet financiare fillojnë nga data 1 janar 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 152, datë 25.4.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4 shtohen emërtimet:

"- Drejtori i marrëdhënieve me jashtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Kryetarët e këshillave të qarqeve dhe inspektorët e marrëdhënieve me jashtë në këto këshilla".

2. Në pikën 4, paragrafi me emërtimin "Kryetarët e këshillave të rretheve dhe kryetarët e bashkive, si dhe personat e ngarkuar për marrëdhëniet me jashtë" shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 153, datë 25.4.2002

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.52, datë 8.1.1996 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Përgjithshëm të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, si dhe administratës së përgjithshme të ndihmës dhe shërbimeve sociale" shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

STATUSI I SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

KREU I

Neni 1

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është institucion shtetëror qendror, nën vartësinë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.
Veprimtaria e tij rregullohet me këtë statut.

Neni 2
Misioni

SHSSH-ja, siguron përkrahjen dhe shërbimet sociale për individë dhe familje në nevojë, nëpërmjet ndihmës ekonomike, institucioneve të përkujdesjes shoqërore dhe shërbimeve të tjera të ngritura për këtë qëllim, si dhe koordinon veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse dhe iniciativave private që veprojnë në fushën e përkujdesit shoqëror.

Neni 3

SHSSH-ja është person juridik publik shqiptar me qendër në Tiranë. Ai vepron me llogari të unifikuar të thesarit dhe ka logon e tij.

Neni 4

SHSSH vepron nëpërmjet administratës qendrore dhe administratës lokale.

KREU II BURIMET E FINANCIMIT DHE PËRDORIMI

Neni 5

Krijohet buxheti social në përputhje me ligjet për financat.

SHSSH-ja financohet nga:

1. Buxheti i Shtetit,
2. donacionet
3. të ardhurat nga pasuritë që zotëron.

Neni 6

Donacionet përbëhen nga:

1. financimet nga organizatat jo fitimprurëse;
2. financimet që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe, me institucionet homologe të huaja;
3. financime nga organizma ndërkombëtare;
4. financime nga persona fizikë dhe juridikë.

Neni 7

Shërbimi Social Shtetëror, në përputhje me planin e nevojave dhe shërbimeve të kërkuara nga strukturat e pushtetit vendor, detajon buxhetin social si një mjet kryesor për mbështetjen e shërbimeve sociale të realizuara nga strukturat publike, private ose organizatat jofitimprurëse.

Përdorimi i fondit të krijuar nga donacionet bëhet me vendim të Këshillit Administrativ të Shërbimit Social Shtetëror.

Nuk lejohet përdorimi i këtij fondi, në këto raste:

- a) për rritjen e pagave të punonjësve të çdo niveli;
- b) për shpërblime dhe honorare;
- c) për udhëtime dhe dieta.

KREU III VEPRIMTARIA E SHSSH-SË

Neni 8

Veprimtaria e SHSSH-së shtrihet në:

1. administrimin e fondit të ndihmës ekonomike;
2. administrimin e fondit të personave me aftësi të kufizuara;
3. administrimin e fondit të shpenzimeve të institucioneve të përkujdesit shoqëror;
4. administrimin e fondit të shpenzimeve të administratës në qendër dhe administratës lokale;
5. administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në rastet kur ato shërbejnë për më shumë se një ndarje administrative;
6. propozimin e buxhetit për fondet e pikave 1,2,3,4,5 dhe ushtrimin e kontrollit nëpërmjet strukturave që ka në varësi për përdorimin e tyre, sipas procedurave dhe afateve që përcaktohen në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë";

7. ndihmën profesionale e bashkëpunimin me institucionet që administrohen nga pushteti vendor;

8. kontrollin dhe mbikëqyrjen, në bashkëpunim me struktura të tjera shtetërore të institucioneve publike dhe private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën sociale, duke verifikuar zbatimin e legjislacionit prej tyre;

9. kryen komisionimet për pranimin e personave të të gjitha kategorive në institucionet e përkujdesit shoqëror;

10. administrimin e fondit të krijuar nga donacionet,

11. ndjekjen e projekteve të paraqitura nga organizatat jofitimprurëse ose iniciativa private në fushën e shërbimeve sociale;

12. bashkëpunon me institucionet homologe dhe organizma ndërkombëtare;

13. bashkëpunon me Pushtetin Vendor;

KREU IV ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHSSH-SË

Neni 9

SHSSH-ja, përbëhet nga struktura që kryejnë funksione drejtuese, ekzekutive dhe shërbime.

Organi më i lartë vendimmarrës është Këshilli Administrativ i SHSSH-së.

Autoriteti më i lartë ekzekutiv është Drejtori i Përgjithshëm. Shërbimet realizohen nëpërmjet administratës lokale të SHSSH-së, zyrave rajonale dhe institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Neni 10

Këshilli Administrativ i SHSSH-së funksionon në bazë të rregullores së tij. Këshilli kryesohet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe përbëhet nga 10 anëtarë të tjerë, të cilët janë përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit e Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Shërbimit Social Shtetëror, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Institutit të Kujdesit Shëndetësor në nivel zëvendësministri ose drejtor drejtorie. Emërimin nominal të anëtarëve të Këshillit Administrativ e bën Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, me propozim të titullarëve të institucioneve të lartpërmendura për një periudhë për 2 (dy) vjet.

Neni 11

Këshilli mbledhet jo më pak se 4 herë në vit. Mbledhjet thirren nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale ose Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së.

Për pjesëmarrjet në mbledhjet e Këshillit, anëtarët marrin shpërblim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Kompetencat e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:

1. Shqyrton projektaktet ligjore dhe nënligjore, që propozohen në lidhje me veprimtarinë e SHSSH-së.

2. Miraton bilancon, raportin vjetor dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës.

3. Miraton rregulloren e organizimit dhe funksionit të SHSSH-së.

4. Miraton në parim kontratat dhe marrëveshjet me organizatat e institucioneve që ushtrojnë aktivitet në fushën e shërbimeve sociale.

5. Vendosi për përdorimin e Fondit të donacioneve.

6. Miraton strukturën e SHSSH-së.

Neni 13
Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i SHSSH-së dhe përgjigjet për punën e tij përpara Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale. Ai emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri, me propozim të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 14
Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së ka këto kompetenca:

1. Drejton veprimtarinë e SHSSH-së.
2. Propozon në Këshillin Administrativ rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme.
3. Propozon në Këshillin e Administrativ strukturën e punonjësve të SHSSH-së.
4. Miraton rregulloret e institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe rregulloret e brendshme.
5. Me miratim të Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, emëron dhe largon nga detyra drejtorët e drejtorive në qendër dhe drejtorët e administratës lokale.
6. Emëron dhe largon nga detyra punonjës të niveleve të tjera të SHSSH-së.
7. Propozon programet kualifikuese për stafin në nivel qendror e lokal dhe miraton programe kualifikuese, që nuk përfshihen në programet e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 15

Drejtorja e Përgjithshme e SHSSH-së kryen veprimtari tekniko-administrative dhe organizohet në drejtori dhe sektorë. Ajo kryen zbatimin, instruktimin, përgatitjen e personelit dhe kontrollin e detyrave që duhet të kryejnë zyrat rajonale, institucionet e përkujdesit shoqëror dhe institucione të tjera në varësi të SHSSH-së.

Neni 16
Zyrat rajonale

Zyrat rajonale janë pjesë e administratës lokale të SHSSH-së, të cilat funksionojnë sipas ndarjeve administrative të Republikës së Shqipërisë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të rregullores së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 17
Institucionet e përkujdesit shoqëror

Institucionet e përkujdesit shoqëror janë pjesë e administratës lokale të SHSSH-së dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të rregullores së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

KREU V
MARRËDHËNIET E SHSSH-SË ME MINISTRINË E PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Neni 18

ShSSH-ja është përgjegjëse dhe raporton përpara Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale, lidhur me informacionin e nevojshëm për :

- ndarjen e fondit të ndihmës ekonomike;
- ndarjen e fondit të personave me aftësi të kufizuara;
- zbatimin e Statutit;

- buxhetit;
- zbatimin e projekteve;
- veprimtarinë e institucioneve që ka në varësi;
- informacionin statistikor.

Neni 19

SHSSH-ja, propozon për miratim nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale:

- projektbuxhetin;
- ndryshimet në legjislacion;
- iniciativa për projekte, studime dhe bashkëpunime;
- ngritjen e institucioneve të përkujdesit shoqëror;
- autorizimin e organizatave jofitimprurëse.

Neni 20

Në zbatim të politikave dhe strategjive të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, SHSSH-ja është përgjegjëse për:

- zhvillimin e politikave sociale;
- hartimin e standardeve kombëtare të shërbimit social;
- përcaktimin e tipologjive të reja të shërbimit;
- licencimin dhe vlerësimin e kapaciteteve të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime sociale;
- monitorizimin e projekteve që janë rezultat i marrëveshjeve shtetërore me efekt në të gjithë vendin;
- përcaktimin e rregullave të bashkëveprimit të shërbimit social shtetëror, publik e privat.

VENDIM

Nr. 154, datë 25.4.2002

PËR TË DREJTAT DHE DETYRAT E INSPEKTORATIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË FARËRAVE DHE FIDANËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh" të nenit 11 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve funksionon pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve dhe përbëhet nga kryeinspektori dhe inspektorët, numri i të cilëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.
2. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve ka të drejtë:
 - a) të ushtrojë kontroll në të gjitha objektet dhe personat, fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin e materialit mbjellës, bimor;
 - b) të pajisë me librezë kontrolli nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, inspektorët e Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve dhe personat e tjerë të autorizuar për këtë qëllim. Modeli i librezës përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.
3. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve ka për detyrë:
 - a) zbatimin e standardeve shqiptare dhe/ose të specifikimeve teknike për farat dhe fidanët, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

b) respektimin e kushteve të domosdoshme agroteknike në ngastrat e prodhimit, të riprodhimit dhe të shumëzimit të farërave e fidanëve, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të bujqësisë dhe Ushqimit;

c) respektimin e rregullave të transportit, ruajtjes, përpunimit, ambalazhimit, etiketimit dhe tregtimit të materialit mbjellës, bimor;

ç) mbajtjen e dokumentacionit të domosdoshëm teknik, në të gjitha hallkat e riprodhimit, shumëzimit dhe të tregtimit të materialit mbjellës, bimor, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit;

d) respektimin dhe kontrollin e kryerjes së procedurave të certifikimit të materialit mbjellës, bimor, të prodhuar në vend, si dhe verifikimin e dokumentacionit të certifikimit për materialin mbjellës, bimor, të importuar;

dh) lëshimin e certifikatës së garancisë si dokument që vërteton konformitetin e cilësive të materialit mbjellës, bimor në mbështetje të dokumentacionit shoqërues, kur e ka atë, i cili vërteton kryerjen e procedurave të certifikimit;

e) zbatimin e kriterëve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për kryerjen e analizave laboratorike të materialit mbjellës, bimor.

4. Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, për zbatimin e masave administrative dhe për kryerjen e detyrës, bashkërendon punën me organet e policisë së shtetit dhe me organet tatimore e financiare.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 155, datë 25.4.2002

PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E ENTIT SHTETËROR TË FARËRAVE DHE FIDANËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve funksionon në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe ka për objekt të punës organizimin dhe kontrollin e të gjithë veprimtarisë, që zhvillohet për materialin mbjellës, bimor, në zbatim të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor".

2. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve ka këto të drejta:

a) të kontrollojë kudo ku prodhohet, riprodhohet, shumëzohet, përpunohet e magazinohet, transportohet, eksportohet, importohet dhe tregtohet material mbjellës, bimor;

b) të bashkëpunojë me organizmat ndërkombëtarë si motra, të vendeve të tjera në fushën e materialit mbjellës, bimor;

c) të bashkëpunojë me institutet kërkimore-shkencore të vendit dhe të jetë bashkërendues i punës së tyre për çvënie në dukje, grumbullimin, studimin dhe ruajtjen e materialeve gjenetike bimore, si dhe me çdo fermer apo subjekt, që ka në pronësi bimë bujqësore, me vlerë gjenetike.

ç) Të organizojë, sipas kërkesave, trajnime për marrjen e mostrave, kryerjen e analizave laboratorike të materialit mbjellës, bimor dhe të japë certifikatë trajnimi.

3. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve përgjigjet për kryerjen e këtyre detyrave:

a) organizimin e punës dhe marrjen e masave për zbatimin e ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) kryerjen dhe mbikëqyrjen e pronave zyrtare të testimit të variteteve të reja të krijuara në vend dhe/ ose të ardhura nga vende të tjera, për regjistrimin e tyre në Regjistrin Themeltar dhe katalogun zyrtar të specieve dhe të variteteve;

Provat zyrtare të testimit të variteteve kryhen në jo më pak se dy vjet për bimët e arave dhe në jo më pak se dy vjet pas hyrjes në prodhim për bimët drufrutorë. Kryerja e provave zyrtare realizohet në këto zona:

- Për bimët e arave: Shkodër, Lushnjë, Korçë dhe Tiranë.

- Për bimët drufrutorë: Tiranë, Vlorë, Sarandë, Korçë, Shkodër dhe Dibër.

Në bazë të të dhënave të provave dhe atyre laboratorike të realizuara, përgatit raportin me shkrim për shqyrtim në Komisionin Shtetëror të Atestimit të Varieteteve.

c) Kryerjen e analizave laboratorike për treguesit cilësorë të varieteteve, që testohen dhe analizave zyrtare të materialit mbjellës, bimor të përcaktuar për tregtim, në laboratorin e ngritur pranë Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve. Gjithashtu, ky Ent mbikëqyr kryerjen e analizave zyrtare në laboratorët e autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

ç) ndjekjen e funksionimit të Bankës Gjenetike dhe të realizimit të detyrave që përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për vënien në dukje, grumbullimin, ruajtjen, studimin dhe vlerësimin e materialit gjenetik bimor, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet kërkimore-shkencore dhe subjektet që zotërojnë material bimor me vlera gjenetike;

d) dhënien e lejeve, sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit për prodhimin, riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës, bimor për tregtim;

dh) mbajtjen dhe plotësimin e Regjistrin Themeltar të specieve dhe të varieteteve dhe marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen e tij;

e) botimin e katalogut zyrtar të specieve dhe të varieteteve të listave A dhe B, çdo pesë vjet, ndërsa ndryshimet vjetore bëhen me shtesa të katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve e sipas rastit dhe sipas listave A dhe B;

f) përgatitjen e etiketës zyrtare, sipas përcaktimeve përkatëse, dhe marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen dhe shpërndarjen e saj;

g) organizimin e sistemit të të dhënave dhe hartimin e rregullave për përmirësimin e vazhdueshëm të marketingut të materialit mbjellës, bimor, sipas kriterëve që përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 156, datë 25.4.2002

PËR ORGANIZIMIN DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË CERTIFIKIMIT TË MATERIALIT MBJELLËS, BIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e" të nenit 11 të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës, bimor", me propozimin e Minisrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, ngarkohet për kryerjen certifikimit të materialit mbjellës, bimor, të përcaktuar për tregtim.

2. Procedurat e certifikimit realizohen nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve ose nga agjenci private, të autorizuara nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Kushtet dhe kriteret e autorizimit për kryerjen e certifikimit apo të procedurave të veçanta përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Certifikimi i materialit mbjellës, bimor realizohet nëpërmjet kryerjes së procedurave të poshtëshënuara:

a) plotësimi i kushteve dhe i specifikimeve teknike, të caktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës, bimor;

b) pastërtia gjenetike;

c) pastërtia fitosanitare;

ç) aprobimet fushorë;

d) analizat laboratorike të treguesve cilësorë;

dh) etiketimi.

Kryerja e procedurave vërtetohet me dokumentet përkatëse, forma dhe mënyra e plotësimit të të cilave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Materiali mbjellës, bimor vlerësohet i certifikuar pasi të jetë pajisur me certifikatën e garancisë, të lëshuar nga Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, e cila vërteton se materiali mbjellës, bimor u është nënshtruar procedurave të certifikimit. Kjo certifikatë lëshohet:

4.1. Për materialin mbjellës, bimor, të prodhuar në vend, kur:

a) subjekti është i pajisur me leje për prodhimin e materialit mbjellës, bimor;

b) subjekti ka paraqitur kërkesë me shkrim për certifikim të materialit mbjellës bimor, bashkëlidhur me mandatin e pagesës së tarifës përkatëse dhe dokumentin, që vërteton të drejtën e pronësisë për varietetin;

c) përpunimi, ambalazhimi dhe riambalazhimi, ruajtja dhe etiketimi është bërë në përputhje me aktet nënligjore;

ç) vërtetohet se varieteti i materialit mbjellës bimor është regjistruar në listat A ose B të katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve, përjashtuar farat e perimeve dhe të luleve.

4.2. Për materialin mbjellës, bimor, të importuar kur:

a) subjekti është pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë tregtare të materialit mbjellës, bimor;

b) subjekti ka paraqitur kërkesë me shkrim për certifikimin e materialit mbjellës, bimor, bashkëlidhur me dokumentin që vërtetojnë kryerjen e procedurave të certifikimit, mandatin e pagesës së tarifës përkatëse dhe dokumentin, që vërteton të drejtën e pronësisë për varietetin.

c) përpunimi, ambalazhimi dhe riambalazhimi, ruajtja dhe etiketimi janë bërë në përputhje me aktet nënligjore;

ç) vërtetohet se varieteti i materialit mbjellës, bimor, është regjistruar në listat A dhe B të katalogut zyrtar të specieve dhe varieteteve, përjashtuar farat e perimeve dhe të luleve.

5. Aprobimet fushorë të materialit mbjellës, bimor, që shumëzohet për qëllime tregtimi kryhen nga grupe specialistësh, nga Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, nga Inspektorati i Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe nga specialistë, të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

6. Tarifat e shërbimeve për kryerjen e procedurave të certifikimit të materialit mbjellës, bimor, dhe të shërbimeve të tjera në funksion të tyre përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

7. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 157, datë 25.4.2002

**PËR KRITERET DHE RREGULLAT E PËRPUNIMIT, AMBALAZHIMIT, RUAJTJES,
ETIKETIMIT DHE PËRMBAJTJES SË ETIKETËS PËR MATERIALIN MBJELLËS,
BIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8732 datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës, bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Quhet material mbjellës, bimor, i gatshëm për tregtim çdo prodhim i realizuar nga mbjelljet për këtë qëllim dhe që u nënshtrohet përpunimit, ambalazhimit, etiketimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës, bimor” dhe me këtë vendim.

2. Subjektet prodhuese dhe tregtuese të materialit mbjellës, bimor duhet të kenë, në pronësi ose në përdorim, magazina e mjedise të përshtatshme, të cilat gjatë përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes dhe tregtimit të këtij materiali sigurojnë temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë, specifikë, për çdo material mbjellës, bimor.

Gjithashtu, subjektet duhet të kenë në pronësi ose në përdorim, impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin e ambalazhimit të materialit mbjellës, bimor.

3. Të gjitha prodhimet e realizuara për përdorim si material mbjellës, bimor, tregtohen si të tilla pasi të jenë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar në përputhje me kërkesat e standardit apo specifikimeve teknike të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Gjatë përpunimit, materialit mbjellës, bimor, sipas rastit, mund të dezinfektohet e peletohet me pesticide e lëndë kimike, ushqyese.

4. Subjekteve, që prodhojnë, përpunojnë e tregtojnë material mbjellës, bimor u lejohet që në magazinat e tyre të përpunojnë, ambalazhojnë e etiketojnë edhe për subjekte të tjera, të ligjëruara për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e materialit mbjellës, bimor, me kusht që në regjistrat e hyrje-daljeve, të regjistrohen të veçanta nga materiali, që do të tregtohet nga vetë ata.

5. Të gjitha farërat e bimëve ruhen dhe tregtohen në parti homogjene e të ambalazuara. Për ambalazhimit përdoren thasë e qese bezeje ose dhe letre, zarfa letre, kuti kartoni, enë qelqi dhe llamarine. Bëjnë përjashtim zhardhokët, bulbat, rizomat e të tjera të ngjashme me to, që ambalazhohen në çastin e tregtimit. Mbyllja e ambalazhit duhet të jetë e tillë, që të jetë e pamundur hapja e tij pa lënë gjurmë.

Materiali mbjellës, bimor drufrutor ruhet i shtratifikuar me bukë dhe ose në mjedise me temperaturë dhe lagështi të kontrolluar. Kushtet teknike të ruajtjes së tij përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Lejohet të ambalazhohen, ruhen e tregtohen përzierje farash për krijimin e tapeteve të gjalbërta, për prodhimin foragjer dhe lulet, me kusht që të jetë e specifikuar me shkrim në ambalazh dhe në etiketë.

6. Tregtimi i çdo materialit mbjellës, bimor bëhet vetëm pas etiketimit me etiketën e prodhuesit dhe etiketën zyrtare.

Etiketa e prodhuesit përfaqëson markën e prodhimit me të gjithë treguesit, sasiore e cilësorë, të deklaruara nga vetë ai.

Etiketa zyrtare përfaqëson të dhënat, sasiore e cilësore, të materialit mbjellës, bimor të verifikuara nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve. Etiketa zyrtare përmban elementë të sigurisë së lartë dhe hidhet në qarkullim vetëm nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

a) Në çdo ambalazh prodhuesi vendos etiketën e vet me ngjyrë të ndryshme nga ngjyra e etiketës zyrtare.

Etiketa e prodhuesit duhet të përmbajë:

- emrin e subjektit,
- numrim e licencës ose të kodit fiskal,
- specien,
- varietetin,
- kategorinë,
- prejardhjen (vendin e prodhimit),
- prodhuesin (kultivuesin i prodhues),
- fuqinë mbirëse,
- datën e analizës së fuqisë mbirëse,
- pastërtinë varietore,
- pastërtinë mekanike,
- trajtimin (emrin e përdorur për produktin e mbrojtjes së bimëve, ose të lëndës kimike për peletim),
- sasinë e materialit mbjellës.

Treguesi i fuqisë mbirëse rianalizohet çdo 6 muaj.

Për materialin mbjellës të bimëve drufrutorë të “varieteti” specifikohen varieteti i mbishtartesës dhe nënshartesës.

Fuqia mbirëse nuk shënohet për tuberat, bulbat, rizomat dhe materiale të tjera shumëzimi, të ngjashme me to.

Për farat e përziara, në etiketë shënohen destinimi dhe përqindja që zë çdo specie apo varietet përbërës.

Në rastet kur materiali mbjellës është i trajtuar kimikisht, në etiketë vihet shënimi; “I pakonsumueshëm nga njerëzit dhe kafshët”.

Një etiketë mund të vendosen edhe të dhëna të tjera shtesë, nëse gjykohet e nevojshme, si për mjediset dhe kushtet e ruajtjes dhe afatin e përdorimit.

Në etiketë nuk mund të vendosen shenja apo elementë të tjerë, që kanë të bëjnë me publicitetin.

b) Çdo kontigjent materiali mbjellës, bimor, që është i përcaktuar për tregtim, krahas etiketës së prodhuesit duhet të ketë edhe certifikatën e garancisë. Gjithashtu, në çdo ambalazh vendoset etiketa zyrtare.

Etiketa zyrtare karakterizohet nga:

Tipi: Është e ngjashme ose jo. Të dhënat mund të shtypen në njërin ose në të dyja anët e saj.

Forma: Duhet të jetë drejtkëndëshe.

Ngjyra: sipas kategorisë së materialit mbjellës, bimor është:

- e bardhë me vija diagonale violet – për kategorinë parabazë ose superelitë;
- e bardhë - për kategorinë bazë ose elitë;
- blu – për kategorinë i/e certifikuar, riprodhimi (gjeneracioni) i parë dhe hibridet F1;
- portokalli – për materialet mbjellëse, të klasifikuara standard, riprodhimi i dytë, etj, tregtare;
- gri – për farat e përziara.

Në etiketat me ngjyrë portokalli dhe gri shënohet numri i riprodhimit (gjeneracionit) përkatës.

Materiali i etiketës: Duhet të jetë i qëndrueshëm ndaj dëmtimeve të zakonshme.

Përmbajtja: Etiketa zyrtare për fara ka këto të dhëna:

- emërtimin dhe adresën e autoritetit që ka lëshuar certifikatën e garancisë (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve);
- numrin e serisë së etiketës;
- specien (shqip dhe latinisht);
- varietetin (kultivar ose hibrid);

- kategorinë;
- numrin e referencës së kontigjentit;
- vendin e prodhimit dhe prodhuesin;
- peshën neto;
- datën e mbylljes zyrtare.

Etiketa zyrtare për materialin mbjellës të drufrutorëve ka këto të dhëna:

- emërtimin dhe adresën e autoritetit që ka lëshuar certifikatën e garancisë (Inspektoriatin e Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve);

- numrin e serisë së etiketës;

- emërtimin dhe adresën e autoritetit që ka lëshuar certifikatën fitosanitare ose që vërteton certifikimin fitosanitar me viruse të kontrolluara ose pa viruse;

- numrin e serisë së etiketës;
- specien (shqip dhe latinisht);
- varietetin e mbishartesës;
- nënshartesat, speciet dhe varietetin;
- kategorinë;
- numrin e referencës së kontigjentit;
- sasinë;
- vendin e prodhimit dhe prodhuesin;
- datën e etiketimit zyrtar.

Të gjitha të dhënat në etiketë duhet të jenë në gjuhën shqipe.

Në rastet e riambalazhimit veprimet kryhen vetëm nën kontrollin e Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve.

Numri i serisë së etiketës u përgjigjet numrave të serisë së etiketave, që janë shënuar në certifikatën e garancisë për çdo kontigjent.

Vendosja e etiketës zyrtare nuk përjashton përgjegjësinë e prodhuesit të materialit mbjellës bimor, për përputhjen e prodhimit me treguesit cilësorë, të deklaruar në etiketën e tij.

7. Në mjediset e shitjes dhe të magazinimit të materialeve mbjellëse, bimore, ndalohet mbajtja e prodhimeve të njëjta, të paambalazuara, të paetiketuara dhe që nuk janë caktuar për këtë qëllim.

8. Ngarkohet Minsitria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM

Nr. 158, datë 25.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.404, DATË 24.10.1991 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE”, NE NDRYSHIMET PËRKATËSE, SI DHE PËR CAKTIMIN E DIETËS DITORE TË MINISTRAVE, ZËVENDËSMINISTRAVE DHE PERSONAVE TË TJERË, TË BARAZUAR ME TA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Pika 6 e vendimit nr.404, datë 24.10.1991 të Këshillit të Ministrave ndryshon si më poshtë vijon:

“6/1. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryetarët e Kuvendit dhe Zëvendëskryeministri, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore në masën 4 000 (katër mijë) lekë në ditë. Kur kthimi bëhet brenda ditës përfitojnë dietë për ushqim në masën 2 000 (dy mijë) lekë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/2. Ministrat dhe personat e tjerë të barazuar me ta, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore, në masën 3 000 (tre mijë) lekë. Kur kthimi bëhet brenda ditës përfitojnë dietë për ushqim në masën 1 000 (një mijë) lekë në ditë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/3. Ministrat dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, të cilët nuk e kanë vendbanimin pranë qendrës së punës, përfitojnë dietë ditore në masën 3 000 (tre mijë) lekë në ditë por jo më shumë se 50 për qind të pagës mujore, ndërsa shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/4. Zëvendësministrat dhe personat e tjerë, të bazuar me ta, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë. Kur kthimi bëhet brenda ditës, përfitojnë dietë për ushqim në masën 1 000 (një mijë) lekë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/5. Ministrat dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, të cilët nuk e kanë vendbanimin pranë qendrës së punës, nuk përfitojnë dietë ditore dhe fjetjeje për ditët e pushimit javor, të festave zyrtare, të lejes së zakonshme vjetore dhe për ditët që janë pranë vendbanimit të tyre.”.

2. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, shtrihen nga data 1 maj 2002 dhe shpenzimet përballohen nga buxhetet vjetore, të miratuara për institucionet përkatëse.

3. Vendimet nr.63. datë 11.2.1993; nr. 115, datë 13.3.1993; nr.351, datë 19.6.1995 dhe nr.621, datë 16.9.1996, të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 176, datë 3.5.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.450, DATË 1.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR ADMINISTRIMIN E QYTETIT ANTIK TË BUTRINTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurive kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në pikën 4 të vendimit nr.450, datë 1.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e qytetit antik të Butrintit", përbërja e anëtarëve të Bordit, të administrimit dhe bashkërendimit të qytetit antik të Butrintit ndryshon si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | Kryetar |
| - Zëvendësministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit | Anëtar |
| - Drejtori i Institutit të Monumenteve të Kulturës | Anëtar |
| - Drejtori i Institutit të Arkeologjisë | Anëtar |
| - Përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit | Anëtar |
| - Drejtori i Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve | Anëtar |
| - Përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme që merret me UNESKO-n | Anëtar |

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 180, datë 3.5.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.227, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCESION TË HIDROCENTRALIT
NË SMOKTHINË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 227, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:
- Pas pikës 3, shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:
"3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen e zbatimin e kësaj kontrate."
- Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:
"4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi."
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 181, datë 3.5.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.355, DATË 27.5.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 355, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave, fjalët "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë".
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 185, datë 3.5.2002

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.397, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË GRAVE SHTATZËNA DHE TË
AMËSISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 100 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 397, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e vecantë të grave shtatzëna dhe të amësisë" të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 4, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji ndalohen të ngrenë pesha mbi 5 kg."
 2. Në pikën 5 paragrafi i tretë, pas fjalëve "... herë pas here gjatë ditës..." shtohen fjalët "... të paguara, jo më pak se 20 minuta për çdo tri orë pune të vazhdueshme ...".
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 186, datë 3.5.2002

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.68, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË
PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1 të pikës 1 të vendimit nr. 68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 28, me këtë përmbajtje:

"28. S SHEN 10080:1999 Çeliku për armaturat e betonit. Çeliku i vjaskuar, i saldueshëm, B500, për armaturat e betonit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 85, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO VENDORE PRIVATE “BOOM BOOM”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “BOOM BOOM RADIO-TV” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqëria “Boom Boom Radio-TV” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 86, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “ADRIA 2”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ADRIATIK 2001” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Adriatik 2001” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 87, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “NEWS 24”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “EDISUD RADIO – TV” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Edisud Radio –TV” sh.p.k. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 88, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV MARGIT”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “MARGIT” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Margit” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 89, datë 29.3.2002

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION FM KOMBËTARE PRIVATE “RADIO +2” SH.A.
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO 2” SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Radio +2” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radio FM kombëtar privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Vendimi nr.30/II pika 1, datë 14.11.2000 i KKRT-së shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.5.2002
Doli nga shtypi më 15.5.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë